Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-417
Datë 30.07.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 17.07.2018 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Kosovo Shooting Academy (KshA), në Prizren me adresë Rruga Qazim Berisha, B1 p.n, për periudhën 17.07.2018 deri 17.07.2021 me kualifikimin:

   1.1. Trajnerët, instruktorët dhe zyrtarët sportiv, Niveli IV sipas KKK me 15 kredi të AAP.

   Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   - Shoqata e bizneseve për edukimin dhe trajnimin për përdorimin e armëve të zjarrit civile dhe sportive "Kosovo Shooting Academy" (KSHA) (më tutje KSHA), në kuadër të dokumentacionit të saj përpos një plan biznesi, nuk ka prezantuar një strategji të qartë zhvillimore të këtij të saj, andaj me qëllim të zhvillimit të saj të mëtutjeshëm, institucioni KSHA, vlerësohet që duhet të ketë një strategjisë zhvillimore. Së bashku me strategjinë KSHA duhet të miratojë edhe një plan të veprimit për zhvillimin e saj tre vjeçar.
   - Me qëllim të punës më efikase dhe të zhvillimit të zhvillimit të programit, KSHA duhet që në objektin e saj, të vendos shenja të qarta udhëzuese për kandidatët si dhe shenja më të qarta për dalje emergjente, të cilat do ti ndihmonin kandidatët.

   (Afati kohor: 31. 12. 2018)

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.
Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi i dërgohet:
- Kosovo Shooting Academy (KshA); dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa